




SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
"Abdyl Ramaj"



Në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues të Shkollës të datës: 08/11/2018, Komisioni i emruar nga KDSH bënë këtë:

FTESË PËR OFERTË / NR. 03/2018

Ftohen të gjithë Operatorët Ekonomik (OE), të cilët ushtrojnë veprimtari për kafeteri, byfe, restorant dhe të ngjashme të ofertojnë në ofertën tonë "DHËNJA NË SHFRYTËZIM E BYFESË SË SHKOLLËS" për tre(3) muaj me mundësi vazhdimi edhe për tre(3) muaj.

Përshkrimi i bufesë së shkollës:

Bufeja e shkollës gjendet në brendi të objektit të shkollës, ka sipërfaqe: $40 + 16 + 18 = 74 \text{ m}^2$. Shkolla ka 800 nxënës dhe 70 puntor të arsimit, shkolla paguan shpenzimet e ujit, mbeturinat, rrymën elektrike përnjë (1) aparat kafe, një(1) frigorifer, një(1) aparat tosti dhe ngrohjen (ky përshkrim ju bëhet OE me qëllim që ata të kenë parasysh kur japin çmimin e ofertës për muaj). Nga OE kërkohet të ofertojnë me një çmim të arsyeshëm marr parasysh se Shkolla paguan shpenzimet e lartëcekura. Po ashtu Shkolla përveq që kërkon qera mujore si të hyra për shkollën, nga OE kërkon të ofertojnë me çmime të arsyeshme të tregut.

Dëshmitë e kërkuara për OE

1. Çertifikata e regjistrimit të biznesit së bashku me informatat për biznesin.
2. Vërtetimi për pagesën e taksave komunale (çertifikata) për tremujorin e fundit në emër të operatorit ekonomik (ky dokument kërkohet vetëm për fituesin e ofertës para nënshkrimit të kontratës).
3. Formulari : Paraqitja e ofertës (ky dokument merret në Drejtorinë e shkollës).
4. Formulari: Lista e artikujve themelor (ky dokument merret në Drejtorinë e shkollës).

Kriter për dhënie të ofertës: Oferta e përgjithshme me çmimin më të favorshëm:

Nënkriter:

1. Çmimi më i lartë i qerasë mujore të ofruar nga OE = 50 pikë
2. Çmimi më i ulët i ofertës për artikujt e kërkuar nga OE = 50 pikë

Totali i poenave = 100 pikë

3. Ngritja e oxhakut e punuar me llamarinë të zinktuar me gjatësi 20m dhe fi 300mm. Oxhaku i ndërtuar të i mbetet shkollës pas skadimit të kontratës .

Afati për tërheqje të formularit të ofertave është 7 ditë : prej datës 13/11/2018 deri më 20/11/2018 ora 10.00 në SHMP "Abdyl Ramaj" në Shirokë .

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave: më 20/11/2018, deri në ora 13:30, zyra e Sekretarit të shkollës.

Hapja e ofertave do të bëhet me datë: 20/11/2018, në ora 14:00 në zyrën e Sekretarit të shkollës.

[Signature] KOMISIONI

